



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE  
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE  
Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj  
Drejtoria e Perpunimit Menaxhimit të Ardhurave

Nr. 5091 Prot.

Tirane, më 13 /2012

**Lenda :Per konfirmim pasqyrash financiare**

**Per shoqerine : "Salillari"**

**Adresa:Ura vajgurore**

**Berat**

Ne pergjigje tuajes me objekt kerkese per konfirmim bilanci , bashkangjitur po ju perezellim te konfirmuar me origjinalin, pasqyrat financiare te shoqerise per vitin 2011

**DREJTORI**  
**Defrim MANOKU**





**SALILLARI L.t.d**

18  
-----  
15-3-12

Nr 86 prot

Ura Vajguore,me 12/03/2012



Drejtuar : Drejtoria e Pergjitheshme e Tatimeve.

Drejtoria Rajonale Tatimore-Njesia e Tatimpaguesve te Medhenj.

Lenda : Dergohen pasqyrat financiare te vitit 2011.


*Z. Doko*  
12/03/2012

Bashkelidhur Ju dergojme 2(dy) kopje te Pasqyrave Financiare te vitit 2011 te shoqerise "SALILLARI"shpk

*Z. Vajguore*  
12/03/12

**ADMINISTRATORI**

**Pellumb SALILLARI**





## SALILLARI sh.p.k

Forma juridike: Shoqëri me Pëgjegjesi të Kufizuar

Data e themelimit: 10 Gusht 1994

Numri unik i indentifikimit(NIPT): J 62903125 G

Selia: Ura Vajguorë ,Berat

E-mail: info@salillari.al, tel. fix (04) 2 253 619, 274 883



Objekti tregtar: Shërbime ndertimi



## Pasqyrat Financiare Vjetore 2011

(Mbyllur me 31.12.2011)

*M.H. Basha*

NJËZËDHET ME ORIGINALIN

DREKTORI

DEFRIM MANOKU


Pasqyra financiare: Individuale(jokonsoliduara)

Periudha kontabel: Nga 01.01.2011 deri më 31.12.2011

Data e mbylljes: 05 Shkurt 2012

Monedha: Leke

Shkalla e rrumbullakimit: ne leke



Berat, Shkurt 2012

## Tabela e përmbajtjes

A. RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR .....	0
B. BILANCI KONTABEL .....	2
C. PASQYRA E TE ARDIHURAVE DHE SHPENZIMEVE .....	3
D. PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE .....	4
E. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALET E VETA .....	5
F. SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE .....	6-16





**AS-Audit Services sh.p.k**

Adresa:Rr. "KOSOVAREVE", ND.35, H.2, Ap.7  
Njesia Bashkiake Nr.5,Tiranë  
(Prane Diges se Liqenit Artificial)  
Cel: 069 20 99 204  
Tel/fax: (04) 2 430 084  
E-mail: as-auditservices@hotmail.com

## **Raport i Audituesit të Pavarur**

**Për Ortakët e Shoqërise "SALILLARI" sh.p.k**  
**Adresa selise: Ura Vajgurore Berat.**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale bashkangjitur, të shoqërisë "SALILLARI" sh.p.k, të cilat përfshijnë bilancin kontabel të datës 31 Dhjetor 2011 dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e fluksit të parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin mbyllur në këtë datë, një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël, si dhe informacionin tjetër shpjegues.

### **Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të), dhe për ato kontrole të brendëshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak mashtimit apo gabimit.

### **Përgjegjësia e Audituesit**

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kerkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale. Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtimit apo të gabimit. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendëshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendëshëm të entitetit.

Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, sikurse dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithëshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatëshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

### Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyre të drejtë, pozicionin financiar të shoqërisë "SALILLARI" sh.p.k, më datën 31 Dhjetor 2011, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur, në përputhje me *Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të)*.

### AS-Audit Services sh.p.k

Afrim Suli

Ortak Kryesor i Angazhimit

Tirane, më 12 Mars 2012





## Bilanci kontabël

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011

(Të gjitha balancat janë në lekë)

Shënime	Viti raportues 31.12.2011	Viti paraardhës 31.12.2010	
<b>A AKTIVET</b>			
<b>I Aktivet afatgjata</b>			
Toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje	4	859,008,117	626,552,899
Emri i mirë		-	-
Aktivet jo-materiale të tjera		-	-
Investime në njësi të kontrolluara	5	100,000	-
Investime në pjesëmarrje	5	-	42,714,000
Aktive afatgjata të investuara dhe të tjera		-	-
<b>Totali aktiveve afatgjata</b>		<b>859,108,117</b>	<b>669,266,899</b>
<b>II Aktivet afatshkurtera</b>			
Inventarët	6	2,733,079	462,142
Llogari të arkëtueshme tregtare	7	2,923,933,549	2,265,739,952
Të tjera aktive afatshkurtera (parapagime, shpenz. e st	8	-	10,357,476
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	9	394,305,880	350,129,559
<b>Totali aktiveve afatshkurtera</b>		<b>3,320,972,508</b>	<b>2,626,689,129</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE (I+II)</b>		<b>4,180,080,625</b>	<b>3,295,956,028</b>
<b>B KAPITALI NETO DHE DETYRIMET</b>			
<b>I Kapitali</b>			
Kapitali neto që i takon zotëruesve të kapitalit të shoq.		-	-
Kapitali themelltar (aksionar)	10	1,381,548,000	1,232,976,000
Rezerva të tjera	10	14,283,063	14,282,740
Fitimet (humbja) të pasqepëmdara		-	-
Fitimi (humbja) e vitit financiar	13	484,653,792	148,572,323
<b>Totali i kapitalit gjithsej</b>		<b>1,880,484,855</b>	<b>1,395,831,063</b>
Interesi i pakicës (-)		-	-
<b>Totali i kapitalit neto</b>		<b>1,880,484,855</b>	<b>1,395,831,063</b>
<b>II Detyrimet afatgjata</b>			
Huatë afatgjata nga bankat dhe institucionet e kreditit	11	-	-
Huamarrje të tjera afatgjata		-	-
Provizione afatgjata		-	-
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>III Detyrime afatshkurtera</b>			
Llogari të pagueshme tregtare dhe llogari të tjera të pa	12	1,818,246,005	1,590,563,880
Hua afatshkurtra		-	-
Kësti afatshkurtër i huave afatgjata		-	-
Të pagueshme ndaj punonjësve	12	8,091,867	8,066,321
Tatim aktual i pagueshëm - Tatime dhe sig. shoqerore	12	4,774,314	10,679,861
Parapagime të arketuara	12	468,483,584	290,814,903
Provizionet afatshkurtra		-	-
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtera</b>		<b>2,299,595,770</b>	<b>1,900,124,965</b>
<b>Totali i detyrimeve (II+III)</b>		<b>2,299,595,770</b>	<b>1,900,124,965</b>
<b>TOTALI I KAPITALIT NETO DHE PASIVEVE (I+II+III)</b>		<b>4,180,080,625</b>	<b>3,295,956,028</b>

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

DREJTORI  
DEFRIM MANOKU  
SIGNALE TITIM





Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve  
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011  
(Të gjitha balancat janë në lekë)

Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti raportues 31.12.2011	Viti paraardhës 31.12.2010
1 Të ardhurat	13.1	1,741,589,237	1,708,666,891
2 Të ardhura të tjera	13.1	5,171,177	2,869,524
3 Ndryshime në inventarin e produk.përfund.prodimit në proces		-	-
4 Punë e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar	13.1	23,976,243	5,072,809
5 Materialet dhe mallrat e konsumuara (-)	13.2	(1,041,839,348)	(907,097,785)
6 Shpenzimet lidhur me përfilimet e punonjësve (-)			
Pagat e personelit	13.2	(73,622,744)	(77,244,663)
Shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	13.2	(11,338,567)	(11,897,871)
7 Shpenzimet e amortizimit (-)	13.2	(90,636,581)	(84,994,576)
8 Zhvlerësimi i tokës, ndërtesave, makineri e pajisje(-)		-	-
9 Shpenzime të tjera (-)	13.2	(304,211,379)	(487,432,061)
10 <b>Totali i shpenzimeve ( 5-9)</b>	13.2	<b>(1,521,648,619)</b>	<b>(1,568,666,956)</b>
<b>11 Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+4-10) 0.143023</b>		<b>249,088,038</b>	<b>147,942,268</b>
12 Të ardhurat dhe shpenzimet nga njësitë e kontrolluara	13.3	-	-
13 Të ardhurat dhe shpenzimet nga pjesëmarrjet	13.3	281,188,668	8,800,000
14 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	13.4	-	-
Të ardhurat,shpenz. financ.investime të tjera			
Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat	13.4	(2,387,699)	-
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	13.4	9,618,075	8,106,829
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare	13.4	-	-
<b>Totali i të ardhurave dhe shpenz. financiare (14)</b>		<b>288,419,044</b>	<b>16,906,829</b>
<b>15 Fitimi (humbja) para tatimit (11+12+13+14) 0.30863</b>		<b>537,507,082</b>	<b>164,849,097</b>
<b>16 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 69</b>	14	<b>52,853,290</b>	<b>16,276,774</b>
<b>17 Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)</b>	13	<b>484,653,792</b>	<b>148,572,323</b>
<b>18 Që u takon:</b>			
Zotëruesve të kapitalit neto të shoqërisë mëmë		-	-
Interesi i pakicës		-	-

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

DREJTORI  
DEFRIM HANOKU



Pasqyra e rrjedhjes së parasë (cash flow)  
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011  
(Të gjitha balancat janë në lekë)

Pasqyra e fluksit monetar – Metoda indirekte	Shenime	Viti raportues 31.12.2011	Viti paraardhës 31.12.2010
<b>I Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>			
Fitimi para tatimit		537,507,082	164,849,097
Rregullime për:			
Amortizimin		90,636,581	84,994,576
Humbje nga këmbimet valutore		-	-
Të ardhura nga investimet		(281,188,668)	(8,800,000)
Shpenzime për interesa		2,387,699	-
<b>Fitimi para tatimit i rregulluar</b>		<b>349,342,694</b>	<b>241,043,673</b>
Rritje/rënie në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga :		(652,842,882)	(89,774,106)
Rritje/rënie në tepricën inventarit		(2,270,937)	2,441,169
Rritje/rënie në tepricën e detyrimeve, për l'u paguar nga aktiviteti		399,470,805	97,183,738
<b>Mjete monetare të përfituara nga aktivitetet</b>		<b>93,699,680</b>	<b>250,894,474</b>
Interes i paguar		(2,387,699)	-
Tatim mbi fitimin i paguar		(47,846,529)	(18,547,403)
<b>Mjete monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</b>		<b>43,465,452</b>	<b>232,347,071</b>
<b>II Fluksi monetar nga veprimtaritë Investuese</b>			
Blerja e shoqërisë së kontrolluar, pjesëmarrje etj.		(100,000)	-
Blerje e tokës, ndërtesës, makinerve dhe pajisjeve		(323,091,799)	(31,835,061)
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata-pjesëmarrjet		306,552,888	-
Interesi i marrë		-	-
Dividendët e arkëtuar-nga pjesëmarrjet		17,349,780	8,800,000
<b>Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet Investuese</b>		<b>710,869</b>	<b>(23,035,061)</b>
<b>III Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare</b>			
Hyrje nga emetimi i kapitalit aksioner		-	-
Hyrje nga huamarrje afatgjata		-	-
Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare		-	-
Dividendët e paguar		-	-
<b>Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>VI Rritja/rënia neto e mjeteve monetare (I+II+III)</b>		<b>44,176,321</b>	<b>209,312,010</b>
<b>Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël</b>		<b>350,129,559</b>	<b>140,817,549</b>
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël</b>		<b>394,305,880</b>	<b>350,129,559</b>

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

DIREKTORI  
DEFINIM TATIMOR  
SALILLARI SH.P.K.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital  
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011  
(Të gjitha balancat janë në lekë)

	Kapitali aksionar	Rivleresime	Rezerva te tjera	Fitime te pashpemdara	Totali
<b>I Gjendja më 31 Dhjetor 2009</b>	992,312,000	-	14,391,252	240,555,488	1,247,258,740
Ndryshimet në politikën kontabël					
<b>Gjendja e rishikuar</b>	992,312,000	-	14,391,252	240,555,488	1,247,258,740
<b>Ndryshimet në kapitalin neto për 2010</b>					
1 Diferenca nga rivlerësimi i Aktiveve Afatgjat	-	-	-	-	-
2 Investime të vlefshme për shitje(fitim/humbj	-	-	-	-	-
3 Mbrojtje e fluksit monetar(fitim/humbje/trasf	-	-	-	-	-
4 Diferenca këmbimi nga përkthimi i transak.	-	-	-	-	-
5 Tatim mbi zërat e marra drejtpërséd. ose të	-	-	-	-	-
6 Te ardhurat neto të njohura drejtpërsédrejt	-	-	-	-	-
7 Fitimi për periudhën	-	-	-	148,572,323	148,572,323
8 Dividentët	-	-	-	-	-
9 Emetim i kapitalit aksionar	240,664,000	-	(108,512)	(240,555,488)	-
10 Opsione të nxjerra mbi aksionet e kapitalit r	-	-	-	-	-
<b>II Gjendja për t'u mbartur më 31 Dhjetor 20</b>	1,232,978,000	-	14,282,740	148,572,323	1,395,831,063
<b>Ndryshimet në kapitalin neto për 2011</b>					
1 Diferenca nga rivlerësimi i Aktiveve Afatgjat	-	-	-	-	-
2 Investime të vlefshme për shitje(fitim/humbj	-	-	-	-	-
3 Mbrojtje e fluksit monetar(fitim/humbje/trasf	-	-	-	-	-
4 Diferenca këmbimi nga përkthimi i transak.	-	-	-	-	-
5 Tatim mbi zërat e marra drejtpërséd. ose të	-	-	-	-	-
6 Te ardhurat neto të njohura drejtpërsédrejt	-	-	-	-	-
7 Fitimi për periudhën	-	-	-	484,653,792	484,653,792
8 Dividentët	-	-	-	-	-
9 Emetim i kapitalit aksionar	148,572,000	-	323	(148,572,323)	-
10 Opsione të nxjerra mbi aksionet e kapitalit r	-	-	-	-	-
<b>III Gjendja më 31 Dhjetor 2011</b>	1,381,548,000	-	14,283,063	484,653,792	1,880,484,855

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i "SALILLARI" sh.p.k dhe jane fimosur nga:

Administratoret

Pellumb Salillari

Isuf Ferra

Financiere

Resmiri Cera

Salillari sh.p.k

Faqe 5 nga 16

*[Signature]*

*[Signature]*

DREJTORI  
DEPRIME MARIKLI

**Shënime për pasqyrat financiare**  
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011**  
**(Të gjitha balancat janë në lekë).**

---

**1. Informacione te pergjitheshme**

"Salillari" sh.p.k, është themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me 10 Gusht 1994 dhe gjendet e regjistruar ne rregjistrin tregtar(QKR), indentifikuar me NIPT-in J 62903125 G.Selia kryesore e shoqerise eshte ne Ura Vajguore Berat.Kapitali rregjistruar aktualisht eshte 1.381.548.000 leke dhe zotrohet nga ortakët pellumb Salillari dhe Isuf Ferra me nga 50% të kuotave.

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise per ushtrimin 2011 kane qene sherbimet ne fushen e nderimeve. Nuk ka segmente shfrytëzimi te identifikuara qartë, për të cilat të kete informacion financiar të veçantë dhe që ndiqen e shqyrtohen rregullisht nga drejtimi për të vlerësuar performancën e tyre.

**2. Deklaratë e pajtueshmërisë me SNRF-të**

Pasqyrat financiare(indivduale) për qëllime të përgjithshme janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNFR-të) dhe me kërkesat e ligjit "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Ne hartimin e tyre shoqeria ka zbatuar SNRF-1, si pasqyrat financiare të parat të saj sipas SNRF-ve. Ajo ka paraqitur pasqyrat financiare më të fundit, sipas kërkesave kombëtare, që nuk janë në të gjitha aspektet në koherencë me SNRF-të.

Informacionin krahasues në këto pasqyra financiare shoqeria ka vendosur ta paraqese vetëm për një vit (SNRF-1,parag.36) dhe si datë e kalimit sipas SNRF-ve dhe bilanci i çeljes është marrë fillimi i veprimtarisë së biznesit më 1 janar 2010.Në bilancin e çeljes sipas SNRF-ve jane perdorur të njëjtat politika kontabël si edhe në pasqyrat financiare të saj te ketij viti, të parat sipas SNRF-ve, me përjashtim të rasteve të lejuara e të specifikuara në paragrafët 13-34B, 36A-36C dhe 37 të SNRF-1, kur ato kanë patur aplikim.

**3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël të zbatuara.**

Në përgatitjen e tyre janë përdorur kontabiliteti mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara dhe parimi i vijmësisë,me përjashtim të informacionit lidhur me fluksin monetar. Paraqitja e tyre eshte bare ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar ("lekë).

**3.1 Bazat e matjes të përdorura**

Bazat e matjes të përdorura në pasqyrat financiare është kosto historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera ( kosto aktuale, vlera neto e realizueshme, vlera e drejtë ose shuma e rikuperueshme) sipas kategorive te aktiveve dhe detyrimeve dhe siç e kerkojne standartet perkatese.

**3.2 Politikat e tjera kontabël të përdorura që janë të rëndësishme për kuptimin e pasqyrave financiare.**

**Aktivet Afatgjata Materiale**

Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-të) bazohen ne modelin e koston dhe zbatohet për të gjithë kategorinë e aktiveve afatgjata materiale.Kosto e një zën të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) që kualifikohet për njohje si aktiv matet me koston e tij. Mbas njohjes fillestare si një aktiv, çdo element i aktiveve afatgjata materiale mbartet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.



Vlera kontabël (neto) e AAM-ve rishikohet në çdo datë raportimi dhe kur ekzistojnë indicacione që ndonjë aktiv të jetë i zhvlerësuar, atëherë drejtimi çmon shumën e rikuperueshme të aktivitetit dhe njëzetë në përputhje me SNK-36 Zhvlerësimi i Aktiveve.

Për të shpërndarë shumën e amortizueshme të një aktivi mbi baza sistematike gjatë jetës së tij të dobishme, shoqëria përdor si metodën e zvogelimit të tepricës e cila sjell një ngarkesë rënëse përgjatë jetës së dobishme. Metoda e amortizimit aplikohet në mënyrë të qëndrueshme, përveç rasteve kur ka një ndryshim në tiparin e pritshëm të marrjes së përfitimeve ekonomike të ardhshme. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e perdorura janë në ndertesa 5 % të vlerës fillestare dhe për aktivet e tjera 20% të vlerës së mbetur.

#### Investimet në shoqëritë e kontrolluara dhe pjesëmarrjet

Investimet në njësitë ekonomike të kontrolluara dhe në pjesëmarrje, në pasqyrat financiare individuale, që nuk janë klasifikuar si të mbajtura për shitje, paraqiten në përputhje me paragrafet 37-42 të SNK 27 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale". Ato njihen fillimisht në kontabilitet me koston e blerjes dhe në pasqyrat financiare pas blerjes, me koston minus zhvlerësimin.

#### Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SNK-2 "Inventarët", kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbarë të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme.

Njohja si aktiv e inventareve bëhet fillimisht me koston që përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e transformimit dhe koston e tjera të ndodhura për sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe gjendjen aktuale. Produktet e gatshme vlerësohen në hyrje me koston standarde që marrin në konsideratë nivelet normale të materialeve, të furniturave, punën, efikasitetin dhe shfrytëzimin e kapacitetit. Ato shqyrtohen rregullisht dhe, po qe se është e nevojshme, ndryshohen duke marrë parasysh kushtet aktuale.

Në bilanc inventarët maten me shumën më të ulët të koston dhe vlerës neto të realizueshme. Çmuarjet e vlerës neto të realizueshme bazohen në evidencën më të besueshme që ekziston, në kohën kur bëhen këto vlerësime dhe marrin në konsideratë luhajtjet e çmimit apo të koston që lidhet drejtpërdrejtë me ngjarjet që ndodhin pas mbylljes së bilancit. Shuma e çdo zhvlerësimi të inventarëve deri në vlerën neto të realizueshme dhe të gjitha humbjet e inventarëve njihen si shpenzim në periudhën kur ndodh zhvlerësimi ose humbja.

#### Aktivitetet financiare

Shoqëria i klasifikon aktivitetet financiare në Llogari/Kërkesa të arkëtueshme nga klientët dhe në Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme. Menaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivitetet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto, pakësuar nga zhvlerësimi nëse ka.

Llogari/Kërkesa të arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësitë ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientët e saj. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar nga klientët ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për t'u arkëtuar vlerësohen në hyrje me koston dhe paraqiten në bilanc të vlerësuar me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t'i mbajtur ato deri në maturim. Një zhvlerësim për rënie vlerë të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur ekzistojnë rrethanat që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për t'u arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së vlerës së llogarive të arkëtueshme, vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, moskryerja apo vonesat në pagesa etj. Shoqëria vlerëson çdo vit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme për secilin klient.



Kërkesa të tjera të arkëtueshme njihen kur njëësia ka një të drejtë për të marrë mjete monetare ose përfitime në të ardhmen si pasojë e një ngjarje të ndodhur, përveç shitjes, dhe kur vlera e përfitimeve matet në mënyrë të besueshme. Kërkesat e tjera të arkëtueshme vlerësohen në hyrje dhe në bilanc me të njëjtën parime si dhe llogaritë e arkëtueshme.

#### Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare përfshijnë mjetet monetare në arkë,banke dhe depozitat me afat. Ekuivalentët e mjeteve monetare janë investime afatshkurtra, shumë likuide dhe të gatshme për t'u konvertuar në shuma të njohura të mjeteve monetare dhe të cilat nuk janë objekt i një rreziku domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të njësisë ekonomike dhe aktivitete të tjera të cilat nuk janë aktivitete investuese ose financuese.

Veprimtari investuese janë blerja, dhe nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.

Aktivitete financuese janë aktivitetet që cojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të dhe huamarrjeve afatgjata ose aftashkurtëra nga njësia ekonomike.

Overdraftet bankare konsiderohen si financim,si flukse nga veprimtaria financiare, dhe si rrjedhim përjashtohen nga mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Paraqitja në bilancin kontabël korespondon me mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

#### Detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata

Detyrimet shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata,bazuar ne percaktimet e SNK-1,"*Paraqitja e Pasqyrave Financiare*".

Huamarrjet afatshkurtër njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit dhe me pas vlerësohen me koston e amortizuar.Huat klasifikohen si detyrime afatshkurtra, përveç rastit kur shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Llogaritë të pagueshme ndaj furnitoreve dhe detyrimet e tjera tregtare, njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore paraqiten me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi në datën e ndërtimit të pasqyrave financiare.

Huat afatgjata vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar. Çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas.

#### Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara.

Zakonisht të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura gjatë një periudhe,si dhe efektet e ndryshimeve në çmuarjet kontabël, përfshihen në fitim ose humbje. Megjithatë mund të ekzistojnë rrethana që një zë i veçantë përjashtohet nga fitimi ose humbja e periudhës aktuale, në zbatim të kërkesave të SNK -8 dhe standarteve të tjera.

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t'u marrë duke marrë parasysh shumat e uljeve dhe zbritjeve tregtare të përfituara.Ato njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve.

Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përllogaritet me besueshmëri.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtit ushtrim kontabel. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

#### Transaksionet me monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2011 janë 1 euro=138.93 leke dhe 1 dollar=107.54 leke.

#### Tatimi aktual mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregetar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2011 është 10 % që ka qenë në ushtrimin e mëparshëm.

#### Informacion mbështetës për zërat e paraqitur në bilancin kontabel, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksit monetar.

#### 4. Aktivet afatgjata materiale- toka, ndërtesa, makineri e pajisje

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale në pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Aktivet të tjera afatgjata materiale	Aktivene proces	Totali
A Kosto e AAM-ve me 01.01.201	201,450,002	136,174,012	900,986,617	24,907,755	5,072,809	1,268,591,195
Shtesat	-	29,049,053	150,160,241	3,238,773	172,409,149	354,857,216
Pakesimet	-	-	(9,797,330)	-	(29,049,053)	(38,846,383)
Kosto e AAM-ve 31.12.2011	201,450,002	165,223,065	1,041,349,528	28,146,528	148,432,905	1,584,602,028
B Amortizimi AAM-ve 01.01.2011	-	40,584,061	587,039,825	14,414,410	-	642,038,296
Amortizimi ushtrimit	-	4,779,495	82,297,864	3,559,222	-	90,636,581
Amortizimi për daljet e AAM-ve	-	-	(7,080,966)	-	-	(7,080,966)
Amortizimi i AAM-ve 31.12.2011	-	45,363,556	662,256,723	17,973,632	-	725,593,911
C Zhvlerësimi AAM-ve 01.01.201	-	-	-	-	-	-
Shtesat	-	-	-	-	-	-
Pakesimet	-	-	-	-	-	-
Zhvlerësimi AAM-ve 31.12.2011	-	-	-	-	-	-
D Vlera neto e AAM-ve 01.01.201	201,450,002	95,589,951	313,946,792	10,493,345	5,072,809	626,552,899
E Vlera neto e AAM-ve 31.12.2011	201,450,002	119,859,509	379,092,805	10,172,896	148,432,905	859,008,117

Si politike kontabel për kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqëria ka zgjedhur modelin e kostos (SNK-16). Në koston e njohjes fillestare të një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa,

makineri e pajisje) jane përfshire çmimi blerjes, përfshirë taksat doganore dhe taksat mbi blerjen jo të rimbursueshme, pasi zbriten skontot tregtare dhe zbritjet tregtare ose kostoja e ndertimit të tij, si dhe çdo kosto të ngarkueshme drejtpërdrejtë për të sjellë aktivin në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi.

Per amortizimin e AAM-ve shoqëria ka zgjedhur metoden e zvogelimit të teprices(amortizim mbi bazen e vleres neto) e cila aplikohet në mënyrë të qëndrueshme dhe është e njëjtë me ato që përdoren për qëllime fiskale. Normat e amortizimit të përdorura marrin parasysh jetën e dobishme dhe masën e tyre vjetore sipas grupeve është shpjeguar në shënimin nr.3. Në datën e mbylljes së bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Vlera kontabël (neto) e AAM-ve është rishikuar nga drejtimi dhe është konstatuar se nuk gjenden indikacione të besueshme që ndonjë aktiv të jetë i zhvlerësuar dhe ka çmuar se vlerat neto të paraqitura nuk tejkalojnë shumën e rikuperueshme të tyre. Klasifikimi i AAM-ve dhe vlerat e paraqitura me siper përputhen me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike e kryer në fund të ushtrimit 2011.

Në aktive afatgjata në proces është pasqyruar parapagimet për blerjen e zyrave të reja të kryera në bazë kontratave të porosisë, në vlerën 148.432.905 , për të cilën ende nuk është marrë titulli i pronësisë. Gjate vitit 2011 janë kryer shpenzime për ndertimin e ambjentëve të magazinimit dhe të atyre ndihmese për vlerën 23.976.243 leke e cila së bashku me vlerën e vitit 2010 prej 5.072.809 leke janë kaluar në fund të ushtrimit në zërin ndertesa. Nga aktivet afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) nuk ka objekte të përdorura si garanci për pasive.

## 5. Investime në shoqëritë e kontrolluara dhe pjesëmarrje

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve të qëndrueshme financiare në pasqyrat financiare paraqiten:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010
Investime në njësi të kontrolluara Hydro-Salillari sh.p.k	100,000	-
Investime në pjesëmarrje Pjesëmarrje në "SKY-2009" sh.a	-	42,714,000
Shuma	100,000	42,714,000

"Salillari" sh.p.k ka zotëruar një pjesëmarrje në shoqërinë "SKY-2009" sh.a prej 42.714 aksione me vlerë nominale 1.000 leke/aksion ose 10% të kapitalit të regjistruar. Gjate ushtrimit 2011 drejtimi vendosi të shesë teresisht aksionet e zotëruara dhe më 10.11.2011 nënshkruan kontratën e shitjes me kusht. Shitja e aksioneve u realizua me çmimin total 306.552.288 leke dhe krijoi një të ardhur neto prej 263.838.888 leke(306.552.288-42.714.000) e cila është pasqyruar në të ardhurat nga pjesëmarrjet të PASH-se.

Gjithashtu shoqëria ka përfituar për vitin 2011 nga dividendi i shpërndarë nga "SKY-2009" sh.a, për shumën 17.349.780 leke e cila është paraqitur në të ardhurat e ushtrimit.

Në 09 Qershor 2011 shoqëria ka krijuar një shoqëri të re të kontrolluar prej saj, "Hydro-Salillari" sh.p.k, me kapital të regjistruar 100.000 leke. Në pasqyrat financiare individuale të "Salillari" sh.p.k ky investim është paraqitur si investim në shoqëritë e kontrolluara.

Fillimisht është njohur kosto dhe në pasqyrat financiare pas krijimit, me kosto minus zhvlerësimin.

"Hydro-Salillari" sh.p.k nuk ka kryer aktivitet për vitin 2011.

## 6. Aktive afatshkurtra-inventari

Gjendjet e inventarit në fillim dhe fund të ushtrimit paraqiten:



	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010
<b>Inventari</b>		
(i) Lëndët e para	2,198,077	278,142
(ii) Prodhim në proces	-	-
(iii) Produkte të gatshme	535,002	184,000
(iv) Mallra për rishitje	-	-
(v) Parapagesat për furnizime	-	-
<b>Shuma</b>	<b>2,733,079</b>	<b>462,142</b>

Politikat kontabel për matjere inventareve është bazuar në SNK-2 "Inventarët". Fillimisht inventaret mjihen me kosto e blerjes që përfshin çmimin e blerjes, taksat e importit dhe tatime të tjera, (përveç atyre që njësisia ekonomike i rikuperon nga autoritetet tatimore) transportin, trajtimin dhe kosto të tjera që i ngarkohen drejtpërdrejt blerjes së mallrave, materialeve dhe shërbimeve.

Produktet e gatshme vlerësohen në hyrje me kostot standarde që marrin në konsideratë nivelet normale të materialeve, të furniturave, punën, efikasitetin dhe shfrytëzimin e kapacitetit. Gjate ushtrimit për daljen e inventareve është përdorur metoda "mesatares se ponderuar".

Vlera e inventarëve të njohura si shpenzim gjatë periudhës kontabël 2011 është 1,041,839,348 leke. Klasifikimi dhe vlerat e inventarit të paraqitura me sipër perputhen me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike e kryer në fund të ushtrimit 2011.

Vlerat e paraqitura të inventarëve janë matur me shumën më të ulët të koston mesatare të ponderuar dhe vlerës neto të realizueshme. Çmuarja e vlerës neto të realizueshme është bazuar përgjithësisht në evidencë të besueshme. Drejtimi mendon për këtë ushtrim kontabel nuk është nevoja për të njohur shumën zhvlerësimi të inventarëve.

Nuk vlera inventarësh të vendosur si peng për pasivet.

## 7. Aktive afatshkurtra- Llogari të arkëtueshme tregtare

Kerkesat e arkëtueshme dhe aktive të tjera financiare, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabel 2011 deklarohen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010
<b>Aktive financiare afatshkurtra</b>		
Llogari / Kërkesa të arkëtueshme	2,918,466,221	2,249,630,632
Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme	5,467,328	16,109,320
Instrumente të tjera borxhi	0	0
Investime të tjera financiare	0	0
<b>Shuma</b>	<b>2,923,933,549</b>	<b>2,265,739,952</b>

Në "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme" janë pasqyruar kerkesat për tu arkëtuar nga klientet për shitjet e shërbimeve të ndërtimit dhe produkteve, të cilat nuk janë arkëtuar në fund të ushtrimit. Në këtë post janë vendosur dhe kërkesa të tjera të arkëtueshme dhe tepricat debitorë të marrëdhënieve me furnitorët. Shumat e paraqitura në "Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme", përbehet nga:

- Shteti-Tatim mbi fitimin, teprica debitorë me 31.12.2011 .....1.877.283 leke
- Hua e perkoshme dhene shoqërisë Hydro-Salillari sh.p.k.....3.590.000 leke

Drejtimi mendon se të gjitha kerkesat do të arkëtohen në një periudhë afatshkurter me vlerën e tyre nominale dhe nuk parashikon rënje në vlerë.



8. Te tjera aktive afatshkurtera

Aktive të tjera financiare afatshkurtra perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010
Aktive të tjera financiare afatshkurtra		
Parapagime dhe shpenzime te shtyra	0	10,357,476
Shuma	0	10,357,476

Parapagime dhe shpenzime te shtyra,gjendje ne fillim te ushtrimit, qe perfaqesonin shpenzime te kryera per ndertimin e apartamenteve te banimit per shitje, jane transferuar ne llogarine e klienteve,se bashku me vleren e situacioneve te ndertimit.

9. Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare (likujditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjeteve monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute, ne datat 31 Dhjetor 2011 dhe 31 Dhjetor 2010 jane si me poshte:

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja ne 31.12.2011		Gjendja ne 31.12.2010	
		Ne leke	Ne valute	Ne leke	Ne valute
Llogari bankare	LEK	393,841,710	-	348,879,895	-
Arka ne leke	LEK	464,170	-	1,249,663	-
Shuma		394,305,880	x	350,129,558	x

Gjendjet e llogarive te likujditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave.

Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit te ushtrimit te bankes respektive.(shih shenimin 3)

10. Kapitalet e veta

Kapitali i rregjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR. Me 31.12.2011 ai eshte 1.381.548.000 leke, i ndare ne 1.381548 pjese( kuota) me vlere nominale 1.000 leke /kuota.

Me vendim te Asamblese se Ortakeve fitimi i vitit 2010 eshte destinuar per te rritur kapitalin e regjistruar.Shtesa e kapitalit te regjistruar eshte ndare perpjestimisht me kuotat qe zoteroin ortaket para zmadhimit.Operacioni zmadhimit eshte depozituar ne QKR dhe gjendet i publikuar.

Raportet e zoterimit te kapitalit te regjistruar dhe ndryshimet qe kane ndodhur per vitin 2011 paraqiten:

Emertimi	Totali	Ndare sipas ortakeve			
		Pellumb Salillari		Isuf Ferra	
		Vlere	Kuota %	Vlere	Kuotai %
Kapitali regjistruar ne 01.01.2011	1,232,976,000	616,488,000	50%	616,488,000	50%
Zmadhim-nga fitimet e pashperndarë	148,572,000	74,286,000	50%	74,286,000	50%
Kapitali regjistruar ne 31.12.2011	1,381,548,000	690,774,000	100%	690,774,000	100%

11. Detyrime afatgjata

Shoqeria nuk ka hua te klasifikuara si afatgjate ne fund te ushtrimit 2011

12. Detyrime afatshkurtera

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2011 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010
<b>Detyrime afatshkurtera</b>		
Llogari te pagueshme tregtare dhe të tjera të pagueshme	1,818,246,005	1,590,563,880
Hua afatshkurtra	0	0
Kësti afatshkurtër i huave afatgjata	0	0
Të pagueshme ndaj punonjësve	8,091,867	8,066,321
Tatimi aktual i pagueshem-Tatime dhe sig shoqerore	4,774,314	10,679,861
Parapagimet e arkëtuara	468,483,584	290,814,903
Provizionet afatshkurtra	0	0
<b>Shuma</b>	<b>2,299,595,770</b>	<b>1,900,124,965</b>

"Llogari te pagueshme tregtare dhe të tjera të pagueshme" perbehen nga detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve te mbetura te pa u likuiduar ne fund te ushtrimit. Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve dhe llogarive te tjera te pagueshme jane paraqitur me vleren e tyre reale.

"Të pagueshme ndaj punonjësve" perbehet nga detyrimi i papaguar ndaj personelit ne 31.12.2011.

"Tatimi aktual i pagueshem-Tatime dhe sig shoqerore" perbehet nga:

- Shteti-tatim mbi vleren e shtuar,.....2.405.378 leke
- Sigurime shoqerore dhe shendetesore per personelin..... 1.546.650 leke
- Tatim mbi te ardhurat nga punesimi.....572.638 leke
- Renta minerare.....249.648 leke

"Parapagimet e arkëtuara" perfaqesojne arketimet e pronotuesve te apartamenteve te banimit, ne baze te kontratave te porosise, per te cilet nuk eshte realizuar kontrata e shitjes dhe transferimi i titullit te pronesise.

13. Fitimi (humbja) e vitit financiar13.1 Te ardhurat nga veprimtaria kryesore

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, te grupuara sipas natyres se tyre paraqitet si vijon:

Emertimi	Viti raportues 31.12.2011	Viti paraardhës 31.12.2010
<b>Te ardhurat nga veprimtaria kryesore</b>		
Te ardhurat nga shitja e produkteve	128,039,804	168,309,520
Te ardhurat nga kryerja e sherbimeve(ne ndertim)	1,613,549,433	1,538,458,195
Te ardhurat nga shitja e mallrave	0	0
<b>Shuma</b>	<b>1,741,589,237</b>	<b>1,706,767,715</b>
Te ardhurat te tjera(materiale,shitje AAM etj.)	5,171,177	4,768,700
Ndryshime në inventarin e produk.përfund.prodimit në proces	0	0
Punë e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar	23,976,243	5,072,809
<b>Shuma</b>	<b>1,770,736,657</b>	<b>1,716,609,224</b>

Te ardhurat nga shitja e mallrave dhe sherbimeve jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, te zhveshura nga TVSH-ja.

Kontratat e ndërtimit qe ka lidhur shoqeria lejojne te përcaktohen saktësisht, të ardhurat dhe kostot e lidhura me këto kontrata dhe njihen si të ardhura dhe shpenzime respektivisht sipas fazës se realizimit të kontratës.Një humbje e prishme nga kontrata e ndërtimit njihet si humbje menjëhere.

## 13.2 Shpenzimet e veprimtarise kryesore

Informacioni mbi shpenzimet e ushtimit bazohet ne klasifikimin sipas natyres se tyre. Ato paraqiten te grupuara ne zerat; materiale dhe mallra te konsumueshme të përdorura; shpenzimet lidhur me përfitimet e punonjësve; shpenzimet e amortizimit; zhvleresimi i tokës, ndërtesave, makineri e pajisje dhe ne zerin shpenzime te tjera. Disa prej tyre jane shpjeguar ne shenimet paraardhese dhe te tjerat jepen në vazhdim.

**Materialet dhe mallrat e konsumuara**

Në këtë post të pasqyres se te ardhurave dhe shpenzimeve, është përfshirë kostoja e marrjes së materialeve të para dhe ndihmëse te konsumuara, kostoja e produkteve te gatshme te shitura, si dhe kostoja e energjisë elektrike, ujit etj.

**Shpenzimet lidhur me përfitimet e punonjësve**

Ne baze te marrëdhënieve kontraktuale te punes, shoqëria llogarit dhe pasqyron vetem përfitimet afatshkurtra te punonjësve qe përfshijnë pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, leja vjetore e paguar dhe raporti mjekësor per 14 ditet e para. Njohja dhe matja gjatë periudhes kontabël, behet me vlerën e paskontuar të përfitimeve afatshkurtra të punonjësit që priten të paguhen në këmbim të shërbimit, si pasiv dhe shpenzim. Pagat, sigurimet shoqërore e shendetesore te punedhënesit dhe numri mesatar i punonjesve sipas kategorite kryesore jane si me poshte :

Kategorite	Ushtrimi 2011 (000 leke)			Ushtrimi 2010 (000 leke)		
	Numer mesatar	Paga	Sgurime punedhënesi	Numer mesatar	Paga	Sgurime punedhënesi
Administrator, menaxher	2	6,000	339	2	6,000	339
Specialist me arsim universitar	12	10,080	1,683	12	10,080	1,683
Teknike	14	9,000	1,503	14	9,000	1,503
Puntor	109	48,543	7,813	117	52,164	8,373
<b>Shuma</b>	<b>137</b>	<b>73,623</b>	<b>11,338</b>	<b>145</b>	<b>77,244</b>	<b>11,898</b>

**Shpenzime te tjera**

Ne zerin "Shpenzime te tjera" pasqyruar ne piken nr.9 te "Pasqyres se te Ardhurave dhe Shpenzimeve" analizohen si vijon:

	Viti raportues 31.12.2011	Viti paraardhës 31.12.2010
Shpenzime te tjera		0
Furnitura, nentrajtime, te tjera te pastokueshme	6,150,648	5,461,951
Telefoni, internet	3,364,325	6,115,334
Qera	-	632,240
Sherbime nga te tretet	274,463,736	448,067,456
Sherbime bankare	450,523	7,983,138
Tatime, taksa dhe derdhje te ngjashme	13,907,201	12,851,619
Shpenzime te tjera rrjedhese	5,874,946	6,320,323
<b>Shuma</b>	<b>304,211,379</b>	<b>487,432,061</b>

Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit.

### 13.3 Te ardhura nga shoqerite e kontrolluara dhe pjesmarrjet

Te ardhurat e realizuara nga investimet ne shoqente e kontrolluara dhe pjesmarrje jane si vijon:

Emertimi	Viti raportues 31.12.2011	Viti paraardhës 31.12.2010
Të ardhurat dhe shpenzimet nga njësitë e kontrolluara	0	0
Të ardhurat dhe shpenzimet nga pjesëmarrjet	-	-
Të ardhurat nga shitja e aksioneve	263,838,888	-
Te ardhura nga dividendet ne pjesmarrje	17,349,780	8,800,000
<b>Shuma</b>	<b>281,188,668</b>	<b>8,800,000</b>

Shpjegimet per te kuptuar natyren e tyre jane dhene ne shenimin nr.5

### 13.4 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare		
Të ardhurat,shpenz. financ.investime të tjera afatgjata		-
Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat	(2,387,699)	-
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	9,618,075	8,106,829
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare	-	-
<b>Shuma</b>	<b>7,230,376</b>	<b>8,106,829</b>

Ato paraqesin fitimet dhe humbjet e vërtetuara gjatë vitit nga kryerja e transaksioneve në monedhë të huaj si dhe nga konvertimi në lekë me kursin e fundit të vitit e gjendjeve të likuiditeteve dhe e te drejtave dhe detyrimeve te shprehura ne monedha te huaja.

### 14. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2011 dhe 2010 jane si vijon:

	Viti raportues 31.12.2011	Viti paraardhës 31.12.2010
I FITIMI NETO PARA TATIMIT	537,507,082	164,849,097
II SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)	8,375,596	6,718,643
1 Amortizime tej normave fiskale	2,500,620	2,073,696
2 Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor	-	-
3 Gjoha,penalite, demshperblime	5,874,976	4,644,947
4 Provizione qe nuk njihen	-	-
5 Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta	-	-
6 Te tjera	-	-
III Divident nga pjesmarrjet rezidente(-)	17,349,780	8,800,000
IV FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)	528,532,898	162,767,740
V Shpenzimi i tatim fitimit-10%	52,853,290	16,276,774
VI FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)	484,653,792	148,572,323



Shpenzimi i tatim fitimit të ushtrimit është i llogaritur mbi fitimin e tatueshem, i cili është rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal, analizuar në tabelën e mësipërme.

Është konsideruar si shpenzim i panjohur për efekte fiskale dhe vlera neto e AAM-ve të shitura që tejkalon çmimin e shitjes pa TVSH të tyre.

Gjithashtu në bazë të nenit 26 të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat", "Pjesëmarrjet që përjashtohen nga tatimi mbi fitimin", në të cilin thuhet se; " Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të një personi rezident përjashtohen, si të ardhura, dividendët dhe ndarjet e fitimit, kur ato shpërndahen nga shoqëritë e ortakëritë rezidente, që janë subjekte të tatimit mbi fitimin, pavarësisht nga kuota e pjesëmarrjes, në vlerë ose në numër, të kapitalit aksionar, të së drejtës së votës apo të pjesëmarrjes në kapitalin fillestar apo aksionar të përfituesit", dividendi i marrë për shumën 17.439.780 leke, është zbritur nga fitimi i tatueshem.

#### 15. Informacione shpjeguese për palët e lidhura

Duke marrë në konsideratë të gjitha marrëdhëniet e mundshme me palët e lidhura, transaksionet e kryera me to, janë bërë sipas termave të njëjta me ato që mbizotërojnë në transaksionet e kryera në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura.

#### 16. Ngjarjet pas dates së bilancit dhe vijimësia

Asnjë ngjarje e rëndësishme nuk është evidentuar ndërmjet datës së bilancit dhe datës kur janë miratuar nga drejtimi këto pasqyrat financiare, si për ngjarjet që mund të ekzistojnë në datën e bilancit dhe për ato që japin të dhëna pas datës së bilancit.

Pasqyrat financiare janë hartuar sipas parimit të vijimesisë dhe nga informacionet e besueshme që zoteron drejtimi nuk ka rreziqe të rëndësishme për të shkaktuar ç'rregullime materiale në vlerën kontabël të aktiveve dhe pasiveve brenda vitit të ardhshëm financiar.

Nga analiza e gjendjes dhe performancës financiare të shoqërisë, rezultoi se në ushtrimin 2011 është rritur shifra e afarizmit dhe fitimi tregtar. Raportet e rentabilitetit për vitin 2011 janë: Fitimi mbi shitjet para shpenzimeve financiare (intresave) 14.3 %, fitimi neto mbi shitjet para tatimit fitimit 33.9 %.

#### 17. Të tjera informacione shpjeguese

##### Pasivët e kushtëzuara dhe angazhimet kontraktuale të panjohura

Drejtimi ka vlerësuar se nuk ekzistojnë ngjarje të shkuara apo angazhime kontraktuale të panjohura që mund të çojnë në të ardhmen, në një detyrim i mundshëm ose të një pasivi të kushtëzuar dhe që nuk janë në kontrollin e shoqërisë.

##### Manaxhimi i Rrezikut Financiar

Në aktivitetin normal të biznesit shoqëria kryen transaksione të shumta me instrumenta financiare dhe për rrjedhim është e ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme financiare që përfshijnë kryesisht riskun e kredisë, riskun e likuiditetit dhe riskun e kursit të këmbimit. Bazuar në informacionin e siguruar nga personeli drejtues rreziqet e mundshme dhe metodat e menaxhimit të tyre jepen në vijim.

**Rreziku i kredisë:** Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë kryesisht për shkak të faturimeve me likuidim të mevonshëm ndaj klienteve të saj. Pjesa kryesore e kërkesave të arketueshme në fund të ushtrimit i i perkasin enteve shtetërore, pra që kanë financime buxhetore.

Drejtimi vlerëson se mundësia e humbjes në vlerën e tregut si rezultat i pamundësisë së klientit për të paguar borxhin është në nivele shumë të ulta.

**Rreziku i kursit të këmbimit :** Shoqëria nuk ka filiale apo dege në vende të tjera gjeografike, por kryen transaksione brenda vendit dhe mban në llogarite të saj likuiditete në monedhe të huaja.

Për shkak të kësaj, ndryshimet në kursin e këmbimit mund të ndikojnë në nivelin e performancës për shkak të ndryshimit të kurseve të këmbimit. Nga të dhënat që zoteron drejtimi mendohet se kurset e këmbimit nuk do ndryshojnë shumë për vitin në vijim. Rreziku i këmbimit menaxhohet kryesisht duke përdorur parimet e përputhjes së aktiveve në valute me detyrimet në valute.

**Salillari sh.p.k**  
**J62903125G**

**INVENTARI I AUTOMJETEVE NE PRONESI TE SUBJEKTIT SALILLARI SH.p.k**  
**31.12.2011**

NR	Lloji Automjeti	Kapaciteti		TARGA	Vlefte
		PESHA MIN kg	PESHA MAX kg		
1	Autobuz Kassbhorer	8900	12600	BR 3765 B	1,800,000
2	Autobuz Benz	3800	5600	AA 763 AT	707,050
3	Kamjuncine Benz	3010	6500	BR 3913 B	700,000
4	Kamjuncine Benz	3200	6500	BR 8347 A	298,915
5	Kamjuncine Benz	1860	2800	BR 9741 A	800,000
6	Kamjuncine Benz	3960	9200	BR 7150A	800,000
7	Kamjuncine Benz	2950	6500	BR 6853 A	700,000
8	Kamjuncine Benz	3295	5600	BR 1678 B	1,300,000
9	Kamjuncine Benz	2250	3500	BR 3114 B	631,500
10	Kamjuncine Benz	2425	3500	AA 766 AT	650,000
11	Furgon Benz	1990	3500	BR 1325 B	1,099,800
12	Kamion Benz	13700	24000	BR 5216 A	5,000,000
13	Kamion Benz	10880	26000	BR 7381 A	2,758,000
14	Kamion Benz	15940	32000	BR 3107 B	2,778,600
15	Kamion Benz	13800	32000	BR 6146 A	5,000,000
16	Kamion Benz	15300	32000	BR 0539 B	4,365,037
17	Kamion Aktros	16250	32000	BR 8049 A	1,659,603
18	Kamion Aktros	16250	32000	BR 8051 A	1,589,524
19	Kamion Aktros	16250	32000	BR 8052 A	1,659,603
20	Kok Trajli Aktros	10400	26000	BR 8054 A	1,765,135
21	Kok Trajli Benz	7650	18000	BR 9925 A	1,044,680
22	Kok Trajli Man	9500	24000	BR 0857 B	825,237
23	Kok Trajli Man	7100	18000	AA 703 AT	500,000
24	Kok Trajli Aktros	7680	18000	BR 3231 B	1,947,600
25	Kok Trajli Aktros	7680	18000	BR 3269 B	1,947,600
26	Kok Trajli Aktros	7680	18000	BR 3235 B	1,947,600
27	Kok Trajli Aktros	7680	18000	BR 3229 B	1,947,600
28	Kok Trajli Aktros	7680	18000	BR 3271 B	1,965,300
29	Kok Trajli Aktros	7680	18000	BR 3230 B	1,965,300
30	Kok Trajli Iveko	7680	18000	BR 3086 B	252,600
31	Gjysem Rimorkio Teknocar	7280	38000	BR 3270B	649,200
32	Gjysem Rimorkio Teknocar	7280	38000	BR 3234 B	649,200
33	Gjysem Rimorkio Teknocar	7280	38000	BR 3228 B	649,200
34	Gjysem Rimorkio Teknocar	7280	38000	BR 3226 B	649,200
35	Gjysem Rimorkio Teknocar	7280	38000	BR 3227 B	655,100
36	Gjysem Rimorkio Biachi	8020	36800	BR 3087 B	126,300
37	Gjysem Rimorkio Teknocar	7280	38000	BR 3272 B	652,100
38	Gjysem Rimorkio Astra	13400	47200	BR 6458 A	807,500
39	Gjysem Rimorkio Metra	10000	47000	BR 0594 B	785,650
40	Gjysem Rimorkio Zorosi	10700	47000	BR 8210 A	1,450,000
41	Gjysem Rimorkio	7500	36000	BR 1736 B	500,000
42	Gjysem Rimorkio	8000	38000	BR 0341 A	450,000
43	Gjysem Rimorkio Minevra	12950	62000	BR 1018 B	6,285,950
44	Gjysem Rimorkio Sfil	7500	41000	BR 4072 B	1,385,000
45	Gjysem Rimorkio	5900	36000	BR 4064 B	400,000
46	Gjysem Rimorkio Alkom	5200	38000	AAR 674	665,000
47	KOK Trajli Scania	7200	18000	AA 758 BG	1,260,000
48	Patca Rama Astra	44100	44100	BR 1508 B	17,210,000

49	Beton Pompe Actros		26600	BR 0554 B	33,870,694
50	Autobetonier Astra	24100	32000	BR 3085 B	7,578,000
51	Autobetonier pompe Iveco		24000	BR 7914 A	3,740,591
52	Autobetonier Man	16300	32370	BR 0648 B	3,523,310
53	Autobetonier Man	16300	32370	BR 0649 B	3,523,310
54	Autobetonier Man	15930	32000	BR 0685 B	3,144,311
55	Autobetonier Man	15930	32000	BR 0687 B	3,145,811
56	Autobetonier Man	15930	32000	BR 0754 B	3,110,849
57	Autobetonier Man	17440	32000	BR 3466 B	1,590,000
58	Autobetonier Man	15930	32000	AA 857 BX	2,000,000
59	Autovinc Savjen	28000	31120	BR 7231 A	1,121,003
60	Autovinc Fiat	10200	24000	BR 9706 A	600,000
61	Kamjon Saurel	8000	17000	BR 2149 A	2,400,000
62	Autobot Uji Benz	7785	12000	BR 8853 A	1,000,000
63	Auto Fshese Iveco		13000	BR 3385 B	3,145,920
64	Bot Nafta Benz	4300	16220	BR 7087 A	4,500,000
65	Bot Sere Benz	10840	16200	BR 7086 A	1,496,000
66	Autobot Nafta Benz	4410	9200	AA 724 AK	1,827,020
67	Minibuz Renault	2301	3900	TR 5290 P	4,100,000
68	Autovetur Tojota		2430	BR 3940 A	900,000
69	Autovetur Mitsubish		2500	BR 9613 A	861,000
70	Autovetur Mitsubish	2000	2510	TR 3776 G	1,850,000
71	Autovetur Mitsubish	1750	2510	AA 439 BX	1,241,000
72	Autovetur Mitsubish	1950	2450	BR 8771 A	1,200,000
73	Autovetur ISUZI	1990	2550	TR 8250 F	404,857
74	Autovetur Benz		1990	TR 0513 J	250,000
75	Autovetur Benz	1925	2450	TR 3440 K	3,083,333
76	Autovetur Benz	1595	2195	TR 6095 S	1,548,000
77	Autovetur Isuzi	1695	2900	TR 4755 P	2,696,760
78	Autovetur Tojota	1790	2790	TR 2284 T	2,568,750
79	Autovetur Ford	1105	1540	TR 9211 S	1,416,667
80	Autovetur Amarok	2111	2820	AA 526 BL	3,363,950
81	Autovetur Landrover	2570	3200	AA 505 AI	17,560,150
82	Autovetur Benz			AA 773 AN	16,529,395
83	Dumper Truck 769 D				19,521,600
84	Dumper Truck 769 D				19,521,600
85	Dumper Perlin 363				1,479,610
86	Dumper Kamatsu Mod.27				2,246,200
87	Autobetoniere Volvo				3,036,548
88	Autoveture Benx	1595	2195	Tr 2166 I	1,000,000
	<b>TOTALI</b>				<b>303,340,723</b>



Salillari Sh.p.k  
Nipt J62903125G

Inventari fizik i gjendjeve te inventarit 31.12.2011

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Kosto e marrjes	Vlera
Materiale					
1	Amonit	Kg	230	197	45,235
2	Kapsolla	Cop	350	139	48,539
2	Cimento	Ton	257	7,116	1,828,879
2	Gazoil	litra	2,152	128	275,425
	Shuma				2,198,078
Produkte e nenprodukte					
	Granil	m3	1,300	350	455,000
	Bordura	Cope	200	400	80,000
	Shuma				535,000
	TOTALI				2,733,078

Administratori  
Pellumb Salillari

